

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
Fakulteti Filozofik - Departamenti i Sociologjisë
Programi: Master



REZYME E TEMËS

Ruajtja e kujtesës për luftën e viteve 1998-1999. Rast studimi: Podujeva me rrethinë

Mentori:
Prof.Ass.Dr. Shemsi Krasniqi

Kandidatja:
Ermelinda Sopa

Prishtinë
korrik, 2026

RUAJTJA E KUJTESËS PËR LUFTËN E VITEVE 1998-1999. RAST STUDIMI: PODUJEVA ME RRETHINË

Mentor: Prof.Ass.Dr. Shemsi Krasniqi

Kandidate: Ermelinda Sopa

HYRJE

Lufta e Kosovës e viteve 1998–1999 përbën një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë bashkëkohore të vendit, duke lënë pasojë të thella në jetën shoqërore, politike dhe kulturore të popullit të Kosovës. Përveç humbjeve njerëzore dhe dëmeve materiale, lufta ndikoi në formimin e identitetit kolektiv dhe në mënyrën se si shoqëria e kujton, e interpreton dhe e transmeton të kaluarën. Ruajtja e kujtesës për këtë periudhë nuk lidhet vetëm me nderimin e viktimave dhe dëshmorëve, por edhe me përgjegjësinë për të dokumentuar ngjarjet historike dhe për t'i përcjellë ato tek brezat e ardhshëm.

Në shoqëritë e dala nga lufta, kujtesa kolektive ka një rol të rëndësishëm. Ajo ndërtohet dhe transmetohet përmes memorialeve, monumenteve, muzeve, ceremonive përkujtimore, dokumenteve historike, krijimeve artistike dhe rrëfimeve të atyre që e kanë përjetuar luftën. Këto forma të përkujtimit bëjnë të mundur që përvojat e së kaluarës të mos mbeten vetëm kujtime individuale, por të shndërrohen në pjesë të kujtesës së përbashkët të një komuniteti. Në këtë kontekst, Podujeva me rrethinë paraqet një rast studimi me rëndësi të veçantë. Gjatë luftës, kjo zonë ishte ndër hapësirat më të prekura nga konfliktet, duke përjetuar luftime të shumta, dëbime të popullsisë civile, masakra dhe humbje të konsiderueshme njerëzore. Si pasojë, në këtë komunë janë zhvilluar forma të ndryshme të ruajtjes së kujtesës së luftës, përmes komplekseve memoriale, varrezave të dëshmorëve, muzeve, aktiviteteve përkujtimore, emërtimeve të rrugëve dhe institucioneve, si dhe përmes trashëgimisë kulturore e rrëfimeve familjare që vazhdojnë të ruhen dhe të përcillen ndër breza.

Qëllimi i këtij punimi ishte të analizoheshin mënyrat se si ruhet kujtesa për luftën e viteve 1998–1999 në komunën e Podujevës dhe rrethinën e saj, duke identifikuar format kryesore të

përkujtimit dhe rolin që ato luajnë në ruajtjen e identitetit kolektiv. Për realizimin e këtij studimi është përdorur qasja cilësore, ndërsa të dhënat janë mbledhur përmes intervistave gjysmë të strukturuar me ish-luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, qytetarë që kanë përjetuar luftën dhe përfaqësues të institucioneve lokale. Këto të dhëna janë plotësuar me analizën e dokumenteve, memorialeve dhe materialeve të tjera që lidhen me ruajtjen e kujtesës së luftës në këtë hapësirë.

Punimi është punuar në shtatë kapituj. Fillimisht trajtohen teoritë kryesore mbi kujtesën kolektive dhe rëndësia e saj në shoqëritë e pasluftës, më pas paraqitet metodologjia e hulumtimit dhe konteksti historik i Luftës së Kosovës, me theks të veçantë në zhvillimet në Zonën Operative të Llapit dhe komunën e Podujevës. Në vijim analizohen rezultatet e hulumtimit, të cilat ofrojnë një pasqyrë mbi format e ruajtjes së kujtesës së luftës dhe perceptimet e pjesëmarrësve lidhur me rëndësinë e tyre. Në fund paraqiten përfundimet, kufizimet e studimit, perspektivat për hulumtime të ardhshme dhe implikimet praktike që dalin nga ky hulumtim. Ky studim synon të kontribuojë në kuptimin më të mirë të rolit që kujtesa kolektive ka në ruajtjen e historisë së luftës dhe në ndërtimin e identitetit shoqëror, si dhe mbi rëndësinë e dokumentimit, ruajtjes dhe transmetimit të kujtesës historike për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

KAPITULLI I.

TEORITË PËR KUJTESËN KOLEKTIVE

Kapitulli i parë trajton bazën teorike të kujtesës kolektive, duke shpjeguar se kujtesa nuk është vetëm një proces individual, por edhe një fenomen shoqëror që ndërtohet dhe transmetohet përmes përvojave të përbashkëta dhe kolektive. Në këtë kuadër paraqiten teoritë kryesore mbi kujtesën kolektive, të cilat theksojnë rolin e shoqërisë në formimin e kujtimeve, rëndësinë e vendeve të kujtesës si memorialet dhe monumentet, si dhe funksionin e ritualeve dhe ceremonive përkujtimore në ruajtjen dhe përcjelljen e kujtesës ndërmjet brezave. Më tej, kapitulli analizon rëndësinë e kujtesës kolektive në shoqëritë e dala nga lufta, me fokus të veçantë në Kosovën e pasluftës. Ai tregon se përvojat e luftës së viteve 1998–1999 kanë ndikuar fuqishëm në formimin e identitetit kolektiv dhe në mënyrën se si ndërtohen narrativat mbi të kaluarën.

KAPITULLI II.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Kapitulli i dytë paraqet metodologjinë e përdorur në realizimin e hulumtimit, e cila mbështetet në qasjen cilësore. Për mbledhjen e të dhënave është përdorur intervista gjysmë e strukturuar, pasi kjo metodë mundëson kuptimin më të thellë të përvojave të pjesëmarrësve lidhur me ruajtjen e kujtesës për luftën e viteve 1998–1999. Studimi është realizuar me një mostër prej dhjetë pjesëmarrësish, ku përfshihen ish-luftëtarë të UÇK-së, qytetarë që kanë përjetuar luftën dhe përfaqësues të institucioneve lokale të angazhuara në ruajtjen e memorialeve dhe organizimin e aktiviteteve përkujtimore.

KAPITULLI III.

LUFTA E KOSOVËS (1998-1999): PËRMBLEDHJE E ZHVILLIMEVE KRYESORE

Kapitulli i tretë paraqet një përmbledhje të zhvillimeve kryesore të luftës së Kosovës gjatë viteve 1998–1999, ku trajtohen shkaqet që çuan në shpërthimin e luftës, formimi dhe organizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), si dhe zhvillimi i luftimeve. Gjithashtu, paraqiten të dhëna mbi dëbimet masive, viktimat, personat e zhdukur dhe dëmet e shkaktuara gjatë luftës. Kurse në pjesën e dytë, kapitulli trajton pasojat e luftës mbi popullatën civile dhe shoqërinë kosovare. Vëmendje i kushtohet ndikimit të luftës në jetën sociale, psikologjike dhe institucionale, si dhe sfidave të rindërtimit pas përfundimit të konfliktit.

KAPITULLI IV.

ZHVILLIMET E LUFTËS NË TREVËN E LLAPIT

Kapitulli i katërt trajton zhvillimet e luftës në trevën e Llapit, me fokus të veçantë në komunën e Podujevës dhe Zonën Operative të Llapit (ZOLL). Fillimisht paraqitet rëndësia strategjike e kësaj zone gjatë luftës, organizimi dhe strukturimi i saj në kuadër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si dhe roli i figurave kryesore në krijimin dhe drejtimin e rezistencës së armatosur. Po ashtu, mënyra se si u organizua veprimtaria ushtarake, zhvillimi i operacioneve luftarake, betejat më të rëndësishme, masakrat ndaj popullsisë civile, dëbimet e banorëve dhe humbjet njerëzore të shkaktuara gjatë konfliktit.

KAPITULLI V.

ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET

Kapitulli i pestë paraqet rezultatet e hulumtimit, të mbështetura në intervistat me ish-luftëtarë të UÇK-së, qytetarë dhe përfaqësues të institucioneve lokale, si dhe në analizën e dokumenteve dhe memorialeve në komunën e Podujevës. Analiza e të dhënave u bë përmes tre formave: analiza tematike, e përmbajtjes dhe diskursive-simbolike. Gjetjet treguan se kujtesa për luftën e viteve 1998–1999 ruhet përmes formave të ndryshme, si memorialet, komplekset përkujtimore, muzetë, emërtimet e shkollave dhe rrugëve, ceremonitë përkujtimore, dokumentet historike dhe rrëfimet familjare. Pjesëmarrësit vlerësojnë se edukimi, dokumentimi i ngjarjeve, vizitat në memoriale dhe përfshirja e institucioneve arsimore e kulturore janë thelbësore për ruajtjen e kujtesës kolektive.

KAPITULLI VI.

PËRFUNDIMET

Kapitulli i gjashtë paraqet përfundimet e hulumtimit, duke i përmbledhur të gjithë kapitujt dhe ndërlidhja edhe me autorët e shumtë vendas dhe të huaj. Po ashtu, kapitulli vë në dukje se ruajtja e kujtesës së luftës kërkon angazhim të vazheshëm institucional dhe shoqëror, me qëllim që ngjarjet historike të dokumentohen, të ruhen dhe t'u transmetohen brezave të rinj në mënyrë të saktë. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se kujtesa e luftës nuk përfaqëson vetëm një rikujtim të së kaluarës, por edhe një element të rëndësishëm në forcimin e identitetit kolektiv, nderimin e sakrificës dhe ruajtjen e së vërtetës historike.

KAPITULLI VII.

KUFIZIMET E STUDIMIT, PERSPEKTIVAT PËR HULUMTIME TË ARDHSHME DHE IMPLIKIMET PRAKTIKE

Kapitulli i shtatë paraqet kufizimet e studimit, perspektivat për hulumtime të ardhshme dhe implikimet praktike të tij. Theksohet se përdorimi i qasjes cilësore dhe numri i kufizuar i pjesëmarrësve nuk lejojnë përgjithësimin e gjetjeve për të gjithë popullatën, ndërsa natyra e ndjeshme e temës mund të ketë ndikuar në mënyrën se si pjesëmarrësit kanë ndarë përvojat e tyre. Megjithatë, studimi ofron një pasqyrë të rëndësishme mbi mënyrën se si ruhet kujtesa kolektive në nivel lokal.